



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

**Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

LEGJISLATURA X  
SESIONI I

Dokument parlamentar

**DRAFT - KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KOMISIONIT**

*(Për periudhën 27 shtator – 15 tetor 2021)*

Miratuar në mbledhjen e komisionit datë 28 shtator 2021

Data e shqyrtimit në komision/ ora	Komision përgjegjës/ Komision për dhënie mendimi	Çështja për shqyrtim	Data e shqyrtimit në seancë plenare	Nismëtar
<b>E martë</b> <b>28.09.2021</b>  <u><b>Ora 10:30</b></u>		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Konstituimi i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut</li> <li>2. Miratimi i programit të punës së komisionit (për periudhën 27 shtator – 05 nëntor 2021).</li> <li>3. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit (për periudhën 27 shtator – 15 tetor 2021).</li> </ol>		
<b>E hënë</b> <b>04.10.2021</b>  <u><b>Ora 10:30</b></u>	<i>Përgjegjës</i>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Akt Normativ nr. 29, datë 13.9.2021 “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3 datë 18.1.2021”.</li> </ol>	<b>07.10.2021</b>	<b>KM</b>

**Punë në komision për periudhën 3-javore:**

1. Projektligj “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
2. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” të ndryshuar”.
3. Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003 “Kodi i familjes” të ndryshuar”.
4. Projektligj “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.
5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Komisionit Evropian, për programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020”.
6. Projektligj “Për bashkëqeverisjen”.
7. Projektligj “Për statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”
8. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së veriut për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut”.
9. Projektligj “Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”.
10. Projektligj “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës për bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar) Rotterdam, 30.01.2017”.

11. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për zbatimin e programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe hartimit në nivel përfundimtar dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave, ratifikuar me ligjin nr. 86/2016”.

**KRYETARE  
KLOTILDA BUSHKA**